



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
DEČANIMA/MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN DEÇAN

Regj.Nr. 2436 / 12

Gjykata Komunale per Kundërvajtje në Deçan, me gjyqtarin Nexhat Musaj dhe sekretaren juridike Hasime Qorraj duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj te pandehurit Visar Ruzhdi Shehu nga Juniku, për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë, e në veshtrim me dispozitat e nenit 30.123,195 dhe nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt.06.12.2012 bie kete:

AKTEVENDIM

PEZULLOHET, procedura kundërvajtëse ndaj te pandehurit Visar Ruzhdi Shehu nga Juniku, për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë, konform nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkaqe te argumentuara në arsyetim te ketij aktevendimi.

ARSYETIM

REPUBLIKA E KOSOVES –AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT –PRISHTINË me kerkesen nr. 01-2336-12 te dates.02.07.2012 ju ka drejtuar kesaj gjykate qe ndaj te pandehurit te zhvillohet procedura kundërvajtëse dhe pas sigurimit te provave te duhura te shpallet fajtor dhe te denohet në bazë te Ligjit.

Me zhvillimin e procedurës kundërvajtëse i pandehuri Visar Shehu, ne mbrojtjen e vet ka deklaruar: Lidhur me kundërvajtjen per te cilen me ngarkon Agjësia Kunder Korrupsionit ne Prishtinë: kam per te deklaruar se per vitin 2011 unë e kam deklaruar pasurinë ne Agjensionin Kosovar kunder korrupsionit per vitin 2011 me daten 17.09.2012. Si provë deshmie gjykates i prezenton vertetimin e fletëparanimit te dokumentacionit perkates per deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes se pasurisë me nr.03-3703/2012 te dates. 17.09.2012.

Andaj Gjykata duke u bazuar në deklaraien e te pandehurit, proven e prezentuar nga ana e te pandehurit, ka ardhur ne perfundim qe te pezullohet procedura kundërvajtëse, andaj ne bazë te rrethanave qe u ceken më lartë është pezulluar procedurën kundërvajtëse konformë nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv te ketij aktevendimi.

Me nga një kopje te ketij aktevendimi njoftohen ushtruesi i kërkeses dhe i pandehuri

U VENDOS NË GJYKATEN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN Regj.nr  
2436 /12 dt 06.12.2012

UDHZIM JURIDIK :

Kundër ketij aktevendimi pala e pa knaqur ka te drejtë të ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes se ketij aktevendimi. Ankesa ushtrohet pa taksuar për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë.

